



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË AUTORITETI I
MBIKËQYRJES FINANCIARE BORDI**

VENDIM

Nr. 55 , Datë 30.03.2011

Ndryshuar me Vendimin nr. 123, datë 25.11.2013

Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë

Në bazë dhe për zbatim të kërkesave të pikës 23 të nenit 14 të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” të pikës 10, të nenit 42 të Ligjit Nr.9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Ligji Nr.9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt” në pikën 10, të nenit 42, i jep të drejtën Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të njohë veprimtarinë e agjentit të brokerit të letrave me vlerë, si veprimtari e lidhur me transaksionet me titujt (letrat me vlerë).

Direktiva 2004/39/EC (MiFID) njeh veprimtarinë e agjentit të brokerit dhe në nenin 4.1.25 e përcakton agjentin si më poshtë:

“Agjent i lidhur, do të thotë një person fizik apo juridik i cili, nën përgjegjësinë e plotë dhe të pakushtëzuar të vetëm të një shoqërie brokerimi në emër të të cilit ai vepron, nxit investimet dhe / ose shërbimet ndihmëse për klientët ose klientët e mundshëm, pranon dhe transmeton udhëzime ose urdhra nga klienti në lidhje me shërbimet për investime ose instrumentet financiare dhe / ose jep këshilla për klientët ose klientët e mundshëm në lidhje me ato instrumenta financiare apo shërbimeve”;

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është nënshkruar me të drejta të plota të Marrëveshjes Multilaterale me Autoritetet e tjera, anëtare të IOSCO-s, “Për shkëmbimin e informacionit”,

Interesimi i disa subjekteve: shoqëri, banka apo individë, të cilët mund të luajnë rolin e agjentit për një broker të licencuar, i cili (ky i fundit) operon në një vend jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në fushën e letrave me vlerë.

Për sa më sipër ,

V E N D O S I

1. Të njohë “veprimtarinë e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, si **veprimtari e lidhur me transaksionet me titujt (letrat me vlerë)**.
 - a. *“Veprimtaria e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë konsiston në:*
 - b. *promovimin e veprimtarisë së brokerit;*
 - c. *marrjen dhe transmetimin e urdhrave apo udhëzimeve nga klientët/klientët e mundshëm;*
 - d. *ofrimin e këshillave për klientët ose klientët e mundshëm në lidhje me titujt dhe instrumentet financiare.”*
2. **Agjenti do të veprojë në emër dhe për llogari vetëm të një brokeri të licencuar të letrave me vlerë në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo të një brokeri të licencuar nga Autoritetet e tjera mbikëqyrëse, anëtare të IOSCO-s, nënshkruese të MMOU.**
3. *“Veprimtaria e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë do të kryhet vetëm nga shoqëritë komisionere ose bankat të licencuara nga Autoriteti në përputhje me nenin 49 të Ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”.”*
4. *“Autoriteti shqyrton kërkesën për kryerjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar, vetëm pasi subjekti, i cili plotëson kërkesat e pikës 3 të këtij vendimi, ka depozituar në Autoritet:*
 - a) *kërkesën për të marrë miratimin për të kryer veprimtarinë e agjentit të brokerit të licencuar;*
 - b) *kontratën e agjentit me brokerin e letrave me vlerë, në emër dhe për llogari të të cilit do të veprojë;*
 - c) *licencën e brokerit të letrave me vlerë, në emër dhe për llogari të të cilit do të veprojë, lëshuar nga Autoriteti përkatës;*
 - d) *rregullat e brendshme që rregullojnë marrëdhëniet me klientin për këtë veprimtari”.*
5. *“Shoqëria që kryen veprimtarinë e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë duhet të respektojë kërkesat e Ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”*

6. *“Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë, shoqëria detyrohet të paguajë ndaj Autoritetit shumën prej 10.000 lekë.” (shfuqizuar)*
7. *“Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit komunikon me aplikantin për agjent mbi plotësimin e kriterëve të këtij vendimi.”*
8. *“Shoqëria që kryen veprimtarinë e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë raporton çdo 6-muaj në AMF mbi veprimtarinë e kryer, sipas formatit të përcaktuar nga Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit.”*
9. Mosrespektimi i kërkesave të këtij vendimi, shoqërohet me sanksionet përkatëse, referuar Ligjit Nr.9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”.
10. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Enkelelda SHEHI**